

# Arrestohet në Shtime 32-vjeçari i kërkuar për vrasje në tentativë dhe lëndim trupor



24/11/2025 19:05

f

**Policia e Stacionit në Shtime ka arrestuar personin e kërkuar E.M. (32 vjeç), i dyshuar për kanosje dhe i shpallur në kërkim për disa raste penale.**

Në njoftimin e lëshuar për media thuhet se reagimi i policisë erdhi pas një ankese të paraqitur nga një qytetar, ku u raportua se i dyshuari e kishte kanosur atë.

“Pjesëtarë të policisë të udhëhequr nga komandanti i stacionit kanë nisur kërkimin e tij. Rreth orës 13:30, policia mori informatë se i dyshuari, së bashku me një të afërm ishte paraqitur në shtëpinë e ankuesit. Gjatë tentimit për tu larguar me një veturë të tipit ‘Pick-up’, E.M. kishte shfaqur një armë zjarri (pistoletë) dhe është arratisur drejt zonës malore të fshatit Zborc”.

“Fillimisht policia ka arrestuar M.M. (43 vjeç), i cili dyshohet se e ka ndihmuar të dyshuarin gjatë arratisjes. Më pas, me vendosjen e njërive policore në zona strategjike në fshatin Carralevë është lokalizuar dhe arrestuar edhe i dyshuari kryesor, pa u rrezikuar pjesëtarët e policisë”, thuhet në njoftim.

Policia theksoi se gjatë kontrollit tek E.M. është gjetur dhe është sekuestruar një armë zjarri me disa fishekë.

I dyshuari ka qenë në kërkim për: posedim të narkotikëve nga Gjykata Themelore në Prishtinë, lëndim të rëndë trupor nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe vrasje të mbetur në tentativë, rast i hapur nga Sektori Rajonal i Hetimeve në Ferizaj.

Ndërsa ndaj të dyshuarit M.M është iniciuar rasti “Ofrimi i ndihmës pas kryerjes së veprës penale”

Për të gjitha veprimet policore është njoftuar prokurori i shtetit dhe me vendim të tij, të dyshuarit janë ndaluar në mbajtje për 48 orë për procedura tjera hetimore.



## Artikuj të ngjashëm



November 24, 2025

**Ikja e kapitalit: Investimet jashtë Kosovës rriten për 55%**



info@lajmi.net  
Tel: +383 49 131 131  
Gr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

RRJETET SOCIALE



## Other Links

Fact-Checking Policy  
Ethics Policy  
Corrections Policy  
Ownership & Funding Information  
Editorial Team Information